

01-060-01-27362-24

16.09.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.26.08.2024, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Sami Ahmeti, Bajram Hashani, Albana Shillova Shalaku, Labinot Mirena dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: Adem Haliti, zyrtar për informim

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Strategjia e Komunikimit dhe Qasja 2024 - 2026
4. Shqyrtimi i kërkesës të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit nr.-I-52 të dt.23.03.2021
5. Shqyrtimi i kërkesës të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit nr. -I-127, të dt.30.09.2020
6. Raporti i dëgjimit buxhetor me pjesëmarrje për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025 - 2027
7. Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve PVF 2023 nga Komuna e Obiliqit
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën për shqyrtim të Strategjisë së komunikimit dhe qasjes 2024-2026.

Enver Gashi – Ne si grup jemi për atë që Strategjia në fjalë të shkoj në Kuvend dhe atje do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Sa i përket pikës së rendit të ditës, ne jemi dakord që të shkoj në seancën e radhës të Kuvendit. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe aprovim Strategjinë e komunikimit dhe qasjes 2024-2026.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit nr.-I-52 të dt.23.03.2021
Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend dhe të shfuqizohet vendimi pasi që operatori ekonomik nuk i ka përmbushë kushtet. E njehta vlen edhe për të gjithë operatorët tjerë të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret dhe kushtet që i kanë pasë të nënshkruara.

Sami Ahmeti – Me vëmendje e dëgjova shkresën që ju e lexuat, por gjithsesi edhe materialet i kemi lexue dhe pa dashtë sot me i dhënë anime politike, vazhdimisht ne kemi cekë se ka vërejtje të tilla. Duke parë listën e përgjithshme, unë besoj se nuk janë vetëm këta dy operatorë ekonomik që nuk i kanë zbatuar kriteret. Sidoqoftë nxjerrja e vetëm këtyre 2 operatorëve prej krejtë asaj liste, po duket pak tendencioze për çka edhe ne do të abstenojmë. Mirëpo, gjithsesi ne do të dëshironim që në seancën e Kuvendit, të kemi arsytetime se cilat janë masat që janë ndërmarrë në këtë rast për operatorët nga Komuna, a janë bërë vërejtjet ashtu siç kanë qenë të parapara, pse ka përfundue kështu dhe pse i kemi lënë aq gjatë sepse kanë kalue shumë paga e në fund krejtë ti tërheqet. Unë mendoj se është drejtim i duhur, por më duket pak tendencioz vetëm te dy operatorë. Sido që të jetë ne këtë çështje do ta bisedojmë në seancën e radhës të Kuvendit Komunal.
Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit nr.-I-52 të dt.23.03.2021.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës, për shfuqizim të vendimit nr. –I-127, të dt.30.09.2020.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo kontratë të shfuqizohet dhe të ndjeken procedurat e mëtutjeshme që ti jepet ndonjë operatori që i ka mjetet financiare dhe dëshiron me punue.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit –I-127, të dt.30.09.2020.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti raportin e dëgjimit buxhetor me pjesëmarrje për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025 – 2027.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që ky raport ti rekomandohet Kuvendit Komunal dhe nëse, dikush ka vërejtje mund ti paraqesë në seancë.

Sami Ahmeti – Secili prej raporteve që tregon transparencën dhe punën e Ekzekutivit është i mirëseardhur për ne dhe si rrjedhojë jemi që kjo pikë e rendit të ditës, të diskutohet në seancën e radhës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomandohet Kuvendit Komunal Raporti i dëgjimit buxhetor me pjesëmarrje për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025 – 2027.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti Planin e Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve PVF 2023 nga Komuna e Obiliqit

Enver Gashi – Ne jemi për atë që edhe kjo pikë të shkoj në seancën e Kuvendit Komunal dhe secili prej anëtarëve të Kuvendit, nëse kanë diçka të japë kontributin e vetë.

Sami Ahmeti – Gjithsesi, edhe ne jemi për që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në seancën e Kuvendit Komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomandohet Kuvendit Komunal Planin e Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve PVF 2023 nga Komuna e Obiliqit.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Enver Gashi nga Dobërdoli, për publikimin e debatit publik në faqen zyrtare të Komunës së Obiliqit. Propozoj që kjo kërkesë ti rekomandohet për shqyrtim Drejtorisë së administratës.

Sami Ahmeti – Realisht kësaj kërkesë i ka dalë afati sepse këta kanë kërkuar me u shpallë në web faqe debati publik që do të mbahet në Milloshevë me dt.23 dhe kjo datë ka kaluar, kështu që ne çkado që bisedojmë është jashtë afatit dhe nuk është e vlefshme si kërkesë.

Kryesuesja – Me dt.23.09. është dhe Drejtoria e administratës është duke u marrë me këtë kërkesë.

Sami Ahmeti – Atëherë, është në rregullë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Drejtorisë së administratës së përgjithshme për shqyrtim kërkesën nga Enver Gashi nr.01-070/05-0022671/24, e dt.09.08.2024.

Kryesuesja – E kemi kërkesën tjetër nga Mehmetali Hasani, kompania sh.p.k. "Kastrioti" për subvencionim të shpenzimeve. Propozoj që kjo kërkesë ti rekomandohet Drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë.

Sami Ahmeti – Ne realisht vazhdimisht kemi proklamue dhe kemi dashtë që të gjitha zonat të përfshihen në transport publik dhe kërkesës si e tillë i mungon përgjegjja ose arsytimi i Drejtorisë që merret me mbulimin e saj. Unë pajtohem që kjo kërkesë të shkoj te Drejtoria, por gjithsesi të merret me seriozitet për arsye se qëllimi jonë si Komunë duhet të jetë që secili qytetarë të ketë qasje në transport publik.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë (DSHPE) për shqyrtim kërkesën nga Mehmetali Hasani nr.01-070/05-0020882/24, e dt.24.07.2024.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju njoftoj se me dt.21.08.2024 kanë ardhë 2 raporte nga Komisioni për monitorimin dhe realizimin e kontratave dhe ne i kemi përfshi në pikën e 4 të rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit, nëse pajtoheni edhe ju.

Enver Gashi – Ne jemi dakord që këto 2 raporte të hyjnë në rend dite për Kuvendin Komunal.

Sami Ahmeti – Edhe pse ne abstenuam në pjesën e parë pikërisht është edhe kjo sepse ndërlihdja e këtij raporti nuk ishte në rregullë. Ne pajtohemi, por është e domosdoshme nëse, bisedohet për shfuqizim të jetë ky raport paraprakisht, kështu që jemi dakord.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal si pikë e 4 e rendit të ditës Raportet e Komisionit për Monitorim të realizimit të kontratave.

Sami Ahmeti – Duke qenë se me 2 shtator fillon viti i ri akademik, do të dëshironim që në seancën e ardhshme të kemi një raport nga Drejtoria e Arsimit, për gjithë rrjedhjen për përgatitjet për regjistrimet e gjimnazistëve dhe atyre në shkollën teknike me numra, në mënyrë që pak a shumë të jemi edhe ne të informuar si Kuvend se si është gjendja, a janë bërë përgatitjet e duhura, a është infrastruktura e duhur dhe a kemi nevojë në diçka si Kuvend me i ndihmue këtij sektori aq të rëndësishëm. Kjo, është një kërkesë më shumë me bashkëbisedue për ndonjë hall ose problem që ne të iu ndihmojmë atyre, që ta zhvillojnë këtë fushë aq të rëndësishme.

Mbledhja përfundoi në ora 11:27

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli

